



## BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM



# PROGRAMI ZGJEDHOR 2021 - 2025 ZGJEDHJET LOKALE

Zgjidh jetë  
voto blertë



### **BASHKIMI DEMOKRATIK PER INTEGRIM ZGJEDHJET LOKALE 2021**

### **ZGJIDH JETË, VOTO BLERTË!**

#### **[I] HYRJA**

Besoni tek e blerta!

Të realizojme bashkë ëndrrën e blertë!

Të zgjedhim kryetarë dhe këshilltarë në komunat tona, të aftë dhe të ndërgjegjshëm, që do t'i zhvillojnë komunat edhe më shumë, të i përfshijnë qytetarët edhe më tepër dhe ta dëgjojnë zërin e tyre çdo ditë.

Ne tek BDI jemi përpjekur që të mbetemi parti e fjalës së dhënë dhe e veprës së realizuar.

Andaj, u dakorduan të gjithë kandidatët që ti përmbahen agjendës së blertë për të përmirësuar cilësinë e jetës.

E blerta nënkupton qytete të pastërta, pa mbeturina rrugëve dhe lagjeve. E blerta do të thotë ujë i pastërt për pierje në të gjitha komunat. E blerta është ajër i pastërt për ne dhe për fëmijtë tanë.

E blerta është jetë. Por njëkohësisht nënkupton edhe infrastrukturë moderne rrugore, energji të pastërt dhe të lirë për të gjithë qytetarët duke krijuar vende të qëndrueshme të punës për ti dhënë shtytje ekonomisë tonë.

Si rezultat i agjendës tonë të re, kandidatët tanë për kryetar të komunave në katër vitet vijuese do të zotohen t'i bëjnë komunat tona edhe më të mira, më të blerta për të jetuar në to.

Pikërisht kjo është agjenda e blertë. E blerta është jetë, jetë më cilësore për të gjithë qytetarët.

#### **[II] PËRBETIMET**

Komunat tona do të qeverisen bashkë, blertë, mençur, pastërt, hapur, drejtë dhe fer. Këto janë pesë përbetimet tona:

##### **[1] Agjenda e blertë**

Që nënkupton investim në menaxhim efektiv me mbeturinat, përfundim të



rrjeteve të kanalizimit dhe ujit të pastër për pije, gasifikim, shtigje vrapimi dhe çiklizmi, parkingje, trafik të lehtësuar, më shumë gjelbërim, më shumë parqe.

### [2] Agjenda dixhitale

Një administratë elektronike është çelësi për shërbim efikas publik por edhe transparent duke dhënë shërbime tërësisht dixhitale.

E-komuna nënkupton edhe dixhitalizim të shkollave, internet të shpejtë, cilësorë dhe të lirë në të gjitha vendbanimet si dhe infrastrukturë përkatëse.

### [3] Agjenda e derës së hapur

Kryetarët e komunave janë në shërbim të qytetarëve dhe komunat tona ju takojnë qytetarëve. Nuk guxon të ketë derë të mbyllur për hallin e qytetarit. Të gjithë qytetarët do të kanë çasje të plotë tek kryetarët e komunave sepse komuna është e tyre.

### [4] Agjenda e përfshirjes së qytetarëve

Politika e përditshme nënkupton marrje të vendimeve të shpeshta dhe të rëndësishme të cilat ndikojnë jetën e përditshme të qytetarëve dhe të ardhmën e tyre. Përfshirja e qytetarëve në vendimarrje nënkupton që vendimet e mëdha nuk do të mirren nga rrethi i ngushtë drejtues i komunës, por nga ju, qytetarët. Të gjithë kryetarët e komunave tona obligohen të organizojnë referendum për të gjitha çështjet e rëndësishme dhe të respektojnë vullnetin e qytetarëve.

### [5] Agjenda zero tolerancë

Të jesh i zgjedhur do të thotë të përfitosh besimin e qytetarëve. Kryetarët tanë të komunave do të sigurojnë dhe mbrojnë këtë besim me çdo kusht. Andaj, risia e këtyre zgjedhjeve është politika ZERO, që nënkupton zero mbeturina, zero keqpërdorim, zero keqmenaxhim, zero korupsion, zero qenë endacak, zero mungesë parkingu, zero ndërtime pa leje, zero qytetarë të lënë pas dore.

### [III] KOMUNA MODERNE DHE RAJONE TË ZHVILLUARA

Vazhdojmë të avancojmë vetëqeverisjen lokale dhe zhvillimin e barabartë rajonal.



Krahasuar me vitin 2005, kur filloi procesi i transferimit të kompetencave dhe u nxit decentralizimi fiskal, të hyrat e komunave u rritën për më shumë se gjashtë herë në vlerë nominale, përkatësisht në vitin 2005, realizimi i të hyrave ishte në 5.9 miliardë denarë, në vitin 2019 ishte 37 miliardë denarë. Në të njëjtën periudhë, të hyrat tatimore ndaj të cilave komuna ka autonomi të arkëtimit u dyfishuan. Në aspekt të pjesëmarrjes së BPV-së, sipas çmimeve aktuale, në vitin 2005 të hyrat e përgjithshme të komunave ishin 1.9% të BPV-së, në vitin 2019 shënuan 5.4% të BPV-së, që do të thotë se pjesëmarrja relative e BPV-së u rrit pothuajse tre herë. Kështu, Republika e Maqedonisë së Veriut hyn në grupin e vendeve me decentralizim të mesëm dhe vlen të përmendet se mesatarja e BE-27 është dukshëm më e lartë, përkatësisht 10.6% të BPV-së.

Duke u nisur nga logjika e pushtetit më afër qytetarëve është garance e demokratizimit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, BDI fuqimisht përkushtohet në avancimin e decentralizimit të pushtetit nga niveli qendror në atë lokal.

Do të ndërtojmë komuna moderne e të zhvilluara, me kompetenca më të mëdha e më tepër financa, transparente e të përgjegjshme, si dhe rajone me zhvillim të barabartë.

Ne jemi për:

### [1] Komuna me më tepër kompetenca

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve që ofron komuna për qytetarët dhe rritje e kompetencave me shërbime të reja. Do të vazhdojë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sa i përket organizimit të asrimit fillor dhe i mesëm, shëndetësia primare, mbrojtja sociale, afirmimi i kulturës, përkrahje për rini dhe sport. Vazhdon transferimi i institucioneve të kulturës në komuna. Themelim dhe funksionim i policisë komunale. Transfer i menaxhimit me tokat ndërtimore dhe bujqësore, si dhe menaxhimi me resurset natyrore minerale (rërë dhe zhavor). Transfer i kompetencave për licenca për veprimtari në fushën e gastronomisë. Menaxhimi me ndërtesat sociale dhe kompetenca në ndarje të ndihmave sociale. Do të vazhdojë decentralizimi i kompetencave nga pushteti qendror në atë lokal në kuadër të dialogut të vazhdueshëm në Këshillin për avancim të decentralizimit të qeverisjes.

Zgjidhjet  
voto blertë



## [2] Komuna me më tepër financa

Synojmë mesataren evropiane si pjesë e buxhetit të përgjithshëm. Rritjet pjesa e shpërndarjes së TVSH për komunat nga 4.5% në 6%, gjithashtu rritet pjesa e shpërndarjes së tatimit personal nga 3% në 6% për komunat. Themelohet Fondi i performancës ku komunat që menaxhojnë suksesshëm me të hyrat e buxhetit komunal do të shpërblehen. Themelohet Fondi i barazimit ku komunat që janë më pak të zhvilluara dhe kanë më pak resurse do të marrin më tepër mjete financiare.

Do të ndryshojmë metodologjinë e shpërndarjes së TVSH për komunat duke rritur kriterin për krye banori. Gjithashtu do të rishikohen dhe ndryshojnë metodologjitë e shpërndarjes së dotacioneve tjera nga pushteti qendror në atë lokal në drejtim të shpërndarjes së drejtë dhe fer.

## [3] Komuna me qeverisje të përgjegjshme

Komunat me borxhe të ngarkuara do të kenë mundësi të shlyejnë duke shfrytëzuar bonde nga niveli qendror me afat 10 vjeçar për të kthyer borxhin.

Komunat të cilat nuk do arrijnë të menaxhojnë buxhetet suksesshëm me fuqi të ligjit do të kalojnë në gjendje financiare jostabile dhe do jenë të detyruara për 3 deri 6 muaj të tejkalojnë atë gjendje duke shfrytëzuar edhe mundësi për bonde nga pushteti qendror, bonde komunale që do i bleje pushteti qendror dhe 'stand-by' kredi nga pushteti qendror.

## [4] Komuna me qeverisje më transparente dhe llogaridhenëse

Buxheti komunal do të miratohet me konsultime paraprake publike me qytetarët. Do të prezantohen projektet para qytetarëve. Do të publikohen raportet financiare dhe transaksionet financiare të komunave.

## [5] Komuna të zhvilluara dhe zhvillim rajonal i barabarta

Do të themelohet Agjencia për zhvillim rajonal dhe lokal, nëpërmjet të cilës do të ndihmohet zhvillim më i shpejtë rajonal duke përkrahur projekte të ndryshme infrastrukturore.

Agjencia do të financohet nga buxheti qendror, por edhe mjete financiare nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare financiare për financimin e projekteve infrastrukturore kapitale për komunat.

Përveç kësaj, përkrahje të konsideueshme në zhvillimin e komunave, do të



ketë edhe përmes projekteve të qeverisë qendrore të financuara përmes institucioneve ndërkombëtare financiare dhe është i rëndësishëm edhe bashkëpunimi tejkuftar, i financiar me mjete nga BE dhe i bashkëfinancuar nga buxheti i shtetit.

Me angazhimin e pushtetit qendror dhe pushteteve lokale, si dhe rritjen e mjeteve për projektet zhvillimore mund të ndikohet më shpejtë mbi ndryshimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në të gjitha komunat. Në të njëjtën kohë, vazhdojnë edhe proceset e decentralizimit institucional me të cilat komunave do t'u jepen më shumë kompetenca në bashkëpunim me ministrinë resoriale.

Për të respektuar rregullën e 1% të BDP të shpërndarjes sipas çelësit për zhvillim rajonal të barabartë institucionet do të jenë të detyruara të raportojnë për shpërndarjen e investimeve në komunat dhe rajonet përkatesë dhe vitin e ardhëm, korigjojnë vlerat në interes të plotësimit të obligimit ligjor për zhvillim të barabartë rajonal.

## [IV] FTESA PËR TË VOTUAR

Vota është e shenjtë dhe ajo duhet të i besohet të ardhmes që garanton një jetë me cilësore për të gjithë qytetarët. Besojmë tek e blerta! E blerta është jetë! Bashkë e bëjmë blertë!

Këto pesë përbetime të përgjithshme nuk janë vetëm një premtim zgjedhor i kandidatëve tanë për kryetarë të komunave por janë kodi jonë i ri i detyrueshëm i sjelljes.

Jetë cilësore për të gjithë qytetarët. Për këtë, do ti mbajm për fjale të gjithë kryetarët e komunave.

Rrugët tona i kemi zgjedhur gjithëmonë bashkë.

Sot po zgjedhim të blertën, po zgjedhim jetën sepse kjo është e ardhmja më e mirë për ne dhe për brezat që vijnë.

## Zgjidh jetë, voto Blertë!

Zgjidh jetë  
voto blertë





**1 Blerim Osmani**  
Jurist  
Bartës liste



**2 Liridon Disha**  
Mjek



**3 Naile Durmishi**  
Edukatore



**4 Veton Murati**  
Ekonomist



**5 Emin Velija**  
Ekonomist



**6 Rushadije R. Halili**  
Doktor i shkencave të  
matematikës



**7 Besim Memeti**  
Sipërmarrës



**8 Fitim Mustafi**  
Student i filologjisë



**9 Shpresa Qazimi**  
Ekonomiste



**10 Mimoza Zulbeari**  
Psikologe



**11 Adem Abdija**  
Ekonomist

## LISTA E KANDIDATËVE PËR KËSHILLTARË KOMUNAL BDI - TETOVË



**12 Arbnore Dehari**  
Psikologe



**13 Dashmir Misimi**  
Jurist



**14 Binas Adili**  
Jurist



**15 Isnisha Hismani**  
Juriste



**16 Ylber Saiti**  
Student i komunikimit  
ndërkombëtar



**17 Endrin Kadriu**  
Inxhinier i mekatronikës



**18 Behare Fetahi**  
Studente e arkitekturës



**19 Gentijan Salihi**  
Profesor i kulturës  
fizike dhe shëndetësore



**20 Burbuqe Aliu**  
Mësimdhënëse



**21 Merita Muradi**  
Kommunikim ndërkombëtar



**22 Ilirjan Livoreka**  
Shkencat politike



**23 Arbian Seferi**  
Inxhinier i mekatronikës



**24 Luiza Alija**  
Juriste



**25 Besar Ismaili**  
Arsimtar i kulturës  
fizike dhe shëndetësore



**26 Enis Shaqiri**  
Kommunikim ndërkombëtar



**27 Fjolla Dehari**  
Ekonomiste



**28 Halid Xhemaili**  
Profesor i kulturës  
fizike dhe shëndetësore



**29 Liridona Kuçi**  
Albanologe / PR & Marketing



**30 Nesrin Skenderi**  
Juriste



**31 Eshtref Dehari**  
Student i administratës  
publike UEJL



Zgjidh jetë  
voto blertë



## Parafjala

Në dy vitet e fundit, ashtu si mbarë bota, edhe ne kaluam nëpër sfida të vështira, sidomos me orën më të errët në historinë e Tetovës që ndodhi më 8 shtator 2021. Qyteti ynë nuk do ta harrojë kurrë këtë tragjedi.

Sfidat me pandeminë nuk kanë përfunduar ende. Kriza ekonomike na godet po aq fort sikurse shumicën e vendeve tjera në botë. Unë besoj se, në këtë kohë të paqëndrueshme, qyteti ynë ka nevojë për udhëheqje me përvojë, të përkushtuar dhe për një plan të qartë për menaxhimin e krizës, rimëkëmbjen e ekonomisë dhe për ta bërë Tetovën një vend më të mirë për të jetuar. Në këto kohëra kjo është një përgjegjësi shumë e madhe. Unë jam gati ta marr përsipër këtë përgjegjësi. Si kryetare komune u desh që të menaxhoja disa situata krize përgjatë tetë viteve të fundit - nga përmbytjet e vitit 2015, krizën me COVID -19 dhe tragjedinë e fundit.

Edhe pse mund të mos e kem arritur 100 për qind atë që doja dhe atë që Ju, me të drejtë, e prisnit për qytetin tonë, e them me besim se ne tashmë kemi arritur shumë.

Ne kemi përfunduar Bulevardin “VS Bato”, shkollën e re fillore “Naim Frashëri”, riparimin e të gjitha shkollave tona, rrugën për në Banjë dhe hapësirën rekreative, sistemet e furnizimit me ujë në rajonet rurale, rindërtimin e rrugëve dhe sistemeve të kanalizimeve në lagje të ndryshme dhe përfunduar rikonstruktimin e qendrës së re rinore.

Ne vendosëm në funksion autobusët tanë dhe, për herë të parë, Tetova ka transport publik. Me hapjen e pishinës për fëmijë dhe rindërtimin e bregut të lumit, ne u ofrojmë familjeve në Tetovë një mundësi të re për rekreacion. Ndërtimi i Bulevardit “Blagoja Toska” tashmë ka filluar dhe do të jetë një kontribut i rëndësishëm për një Tetovë pa rrugë të bllokuara dhe kaos trafiku. Kamionët e rinj të mbeturinave, të cilët i kemi vënë në punë në shtator, së bashku me kontejnerët e ri, do të ndihmojnë për ta mbajtur qytetin tonë të pastër.

Ka ende shumë punë për ta bërë Tetovën tonë një komunë të pastër dhe të denjë për jetën e të gjithë qytetarëve. Me këtë program, unë ua prezantoj planin tonë për katër vitet e ardhshme dhe angazhimin tim me përkushtim të plotë për ta bërë Tetovën më të mirë, më moderne dhe më të gjelbër.

Ky program përfshin zgjidhje për menaxhimin e mbeturinave, infrastrukturën rrugore moderne, duke përfshirë unazën e re për ta lehtësuar trafikun, parkimin e automjeteve në qendër të qytetit dhe shtrirjen e transportit publik nëpër fshatra.

Ky program parasheh ndërtimin e objekteve të reja sportive dhe rekreative, të parqeve dhe hapësirave të gjelbra dhe politikën e tolerancës zero për ndër-

tesat ilegale. Toleranca zero do të zbatohet edhe për mbeturinat dhe qentë endacakë. Me këtë plan, në të ardhmen, ne do ta lëvizim Tetovën si komunë moderne, të gjelbër dhe transparente.

Shpallja e Malit Sharr si park kombëtar hap mundësi të reja për Tetovën tonë. I mundëson asaj që të bëhet qendër turistike dhe ne do të hapim vende të reja pune në turizëm dhe ekonomi të gjelbër.

Plani ynë për katër vitet e ardhshme është ambicioz, por i përgjegjshëm. Çdo 100 ditë unë do t'i raportoj publikut për progresin e arritur.

Së bashku për një Tetovë me një të ardhme të ndritur. Zgjidh jetë, voto blertë!



Zgjidh jetë  
voto blertë



1

## Zhvillimi urban: Një qytet i gjelbër për një jetë më të mirë!

Tetova është më shumë se një qytet. Ajo është qendra e rajonit të Pollogut. Si e tillë, ajo meriton infrastrukturë moderne që siguron trafik të pangarkuar, hapësira të mjaftueshme parkimi dhe lëvizje të sigurt për këmbësorët dhe ngasësit e biçikletave. Në katër vitet e fundit kemi filluar rindërtimin e rrugëve në Tetovë për t'i azhurnuar si për një qytet me fluks në rritje. Tani po shkojmë një hap tutje – të ndërtojmë unazën, e cila do ta evitojë kaosin e trafikut në qytet, kurse me parkim të organizuar do të krijojmë më shumë hapësirë për të lëvizur dhe për të jetuar më mirë.

Përfundimi dhe sigurimi i rrjetit të ujit të pijshëm është njëri nga qëllimet tona më të rëndësishme për vitet e ardhshme, pasi tashmë kemi siguruar një pjese të madhe të qytetit me furnizim me ujë të pijshëm. Tashmë impianti i ri i trajtimit të ujërave të zeza do të fillojë të ndërtohet për të mbrojtur mjedisin dhe ujërat nëntokësorë.

Por për ne, zhvillimi urban do të thotë më shumë se rrugë, furnizim me ujë dhe trajtim i ujërave të zeza. Do të thotë një qytet i gjelbër për një jetë më të mirë. Rinovimi i bregut të lumit, si hapësirë rekreative, tashmë ka filluar dhe për të gjitha zonat urbane kemi një moto: Pemë në vend të betonit! Duke filluar nga sheshi kryesor, ku do të ndërtojmë hapësira të gjelbra, do të rinojmë parqet dhe këndet e lojërave nëpër lagje, do të sigurohemi që për çdo ndërtesë të re të krijohet një zonë e gjelbër. Për ta parandaluar mungesën e infrastrukturës publike, për të siguruar që ndërtesat të jenë në përputhje me standardet moderne të sigurisë dhe ekologjisë dhe për ta mbajtur qytetin në rregull, por edhe për më shumë drejtësi, ne do të zbatojmë një politikë të tolerancës zero për ndërtimet pa leje.

Transporti publik në qytet është e ardhmja dhe ne tashmë e kemi vënë këtë në funksion, për herë të parë në Tetovë. Jo vetëm që ne do ta zgjerojmë këtë rrjet, por do të investojmë në transport të ri dhe modern në qytet dhe në fshatra.

## Përgjatë katër viteve ne realizuam:



Ndërtimi i bulevardit  
“V.S. Bato”

Vënia në funksion e  
transportit publik



- Vazhdimin e bulevardit “Blagoja Toska”;
- Shtigje biçikletash;
- Parkingje zonale;
- Ndërtimin e shëtitores së lumit Shkumbin.



## Gjithashtu, gjatë këtyre katër viteve, u bënë punët e mëposhtme:

### Rikonstruktimi i rrugëve:

116, 172, “Gjoce Stojcevski”, “Goce Delçev”, tri rrugë pas Gjimnazit të Tetovës, një pjesë e rrugës për në kazemat e qytetit, rruga “Jane Sandanski”, “Dritan Hoxha”, “S.Pinxhur”, Rruga e Studentëve, Rruga e Strugës, një pjesë e Bulevardit Industrial, Blloku 4 në lagjen Drenovec, rikonstruimi i plotë i rrugës “Murat Bafqari”, si dhe asfaltimi i plotë i rrugës Tetovë – Kodër e Diellit me gjatësi 22 km.

- Ndërtimi i urës së Kazazëve
- Rikonstruktimi i rrugës dhe shtigjeve të këmbësorëve nga Kazerma në Stadiumin e vjetër të qytetit
- Asfaltimi i rrugës nga stadiumi i qytetit deri në fshatin Xhepçisht

### Ndërtimi i rrjeteve të furnizimit me ujë në:

- Lagjen Bregu i Diellit;
- Fshatin Poroj;
- Fshatin Reçicë e Madhe;
- Ndërtimi i një rezervuari të ujit të pijshëm në fshatin Gajre;
- Ndërtimi i një rezervuari në fshatin Lisec dhe lagjen Bregu i Diellit

### Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike në:

- Rrugën 185
- Rrugën 186, rrugën “Pjetër Guli” dhe “A.J. Zhurçin”, Pazari i Epërm, Kulla 217
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal

## Projektet e ardhshme:

- Ndërtimi i një unaze në Tetovë përmes kryqëzimit Trebosh – Neproshten. Përgatitja e dokumentacionit të projektit ka filluar në korrik të vitit 2021 dhe afati përfundimtar është muaji maj i vitit 2022. Sipas programit të projektit, do të përgatitet dokumentacioni i projektit për ndërtimin e një Bypass – i të ri të Tetovës me gjatësi prej rreth 5.5 km dhe gjerësi të rrugës së asfaltuar prej 6.6 m.

Ndërtimi i kësaj unaze do ta shmanjë ndjeshëm frekuencën aktuale të lartë të trafikut nëpër Tetovë dhe vendbanimeve përreth. Gjithashtu do ta rrisë sigurinë dhe komoditetin e përdoruesve të rrugës.

Fondet për ndërtimin e kësaj unaze do të sigurohen nga Programi Vjetor për vitin 2022 nga Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore.

- Vazhdimi i bulevardit “Blagoja Toska” – pas përfundimit të fazës së parë deri te shkolla e mesme tekstile, do të vazhdohet me hapjen e pjesës tjetër, nga shkolla e mesme tekstile deri te rrethrotullimi që e lidh këtë bulevard me bulevardin “Ilindenska”.
- Furnizimi i disa zonave në qytet me internet falas – WiFi free zone.
- Hapësira të gjelbra në qytet.
- Rusino – Me qëllim të përmirësimit dhe menaxhimit me mbetjet e ngurta në rajonin e Pollogut në deponinë Rusino, shteti përfitoi fonde nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike për fazën e parë dhe të dytë. Faza e parë e projektit, e cila tashmë ka përfunduar, siguron ndihmë teknike për zhvillimin e sistemit të integruar për menaxhim rajonal me mbeturinat në rajonin e Pollogut, përfshirë përpunimin e planit rajonal për menaxhim me mbetjet dhe formimin e ndërmarrjes rajonale.


Gjithashtu, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, këtë vit kanë dorëzuar kërkesë për hua nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Fondet do të destinohen për vendosjen e sistemit rajonal për menaxhim të mbeturinave. Domethënë për ndërtimin e një deponie standarde dhe për stacionet e transferimit në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë të BE-së, si dhe prokurimin e kamionëve dhe kontejnerëve për të gjithë komunat në rajonin e Pollogut.

Zgjidhjet  
voto blertë



Vazhdimi i bulevardit industrial drejt fshatit Poroj Pas përfundimit të fazës së parë të vazhdimit të bulevardit industrial, instalimit të ndriçimit publik, vendosjes së rrjetit të ri të kanalizimit fekal dhe atmosferik, rregullimit të trotuareve, vendosjes së sinjalistikës horizontale dhe vertikale, synimi i ardhshëm infrastrukturor është vazhdimi i shtegut të ri deri në fshatin Poroj.



- **Rrugë njëkahëshe në qytet - Me ndërtimin e bulevardëve “VS Bato” dhe “Blagoja Toska”, si dy arterie të reja kryesore që shmangin ngarkesën në trafik dhe pas analizave nga ekspertë të sektorit të komunikacionit, paraqitet mundësia që disa nga rrugët kryesore në pikat qendrore të qytetit të bëhen rrugë njëkahëshe.**

- **Kthimi i “Rrugës së Butikëve” në rrugë me vlera kulturore dhe artizanale – “Rruga e Butikëve” mbetet për Tetovën një vlerë kulturore. Ajo, mbi të gjitha, i fuqizon gratë si ndërmarrëse dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik të vendit. Në mandatin vijues e planifikojmë rindërtimin e kësaj rruge duke përfshirë ndriçim publik dhe pajisjet urbane.**




Rrëmuja dhe kaosi në trafik buron edhe nga mungesa e vendeve të parkingjeve publike. Prandaj intervenimi në sheshin kryesor të qytetit është i domosdoshëm. Në mandatin tonë kemi synim parësor që Tetovës t'i japim një shesh publik urban dhe modern, i cili do të plotësojë nevojat e qytetarëve. Prandaj shpallja e projektit ideor dhe më pas e projektimi themelor do të jetë prioritet yni si administratë komunale. Njëkohësisht, sheshi do të jetë një vepër moderne arkitektonike dhe hapësirë e cila do t'i shërbejë qytetarit.

Zgjidhjet  
voto blertë







**Ndërtesë e re  
komunale**



Një nga problemet jetike të efikasitetit administrativ dhe ofrimit të shërbimeve cilësore ndaj qytetarit është edhe sigurimi i një hapësire të re të ndërtesës së komunës. Në vizionin tonë dhe një prej pikave kryesore programore është që të sigurojmë “ONE STOP SHOP” shërbime për qytetarët tanë. Kjo mundësohet vetëm duke siguruar hapësira të reja për komunën e Tetovës. Një ndërtesë multifunktionale e cila do të ngërthente në vete të gjithë njësitë rajonale dhe vendparkerim. Kjo është shumë e rëndësishme për ta lehtësuar komunikacionin në qytetin e Tetovës. Ndërtesa e re do të ofrojë kushte pune optimale për të gjithë të punësuarit në komunën e Tetovës. Kjo lidhet ngushtë me ofrimin e shërbimeve cilësore dhe efikase për qytetarët. Ndërtimi do të jetë në përputhje me standardet për efikasitet energjetik, si dhe do të siguronte vendparkerime në pjesën qendrore të qytetit për qytetarët e Tetovës.

- Zbritje në taksat e ndërtimit për të gjithë ata që do të angazhohen të aplikojnë në ndërtime me kulme të gjelbra.



2

**Zhvillimi rural:**  
Tetova është më shumë se vetëm një qytet!

Tetova jonë është më shumë se vetëm një qytet. Tetova jonë është qyteti, janë fshatrat, janë malet. Ne kemi filluar dhe përfunduar ndërtimin dhe rindërtimin e rrugëve, sistemet e ujërave të zeza dhe mbrojtjen nga përmytjet dhe rrëshqitjet e tokës. Ne kemi rinovuar shkollat nëpër fshatra dhe kemi investuar në furnizimin me ujë. Tani është koha për t'i bërë fshatrat e Tetovës gati për të ardhmen, për të ndërtuar infrastrukturë të gjelbër për një jetesë më të mirë dhe për një turizëm të qëndrueshëm.

Me Parkun Kombëtar të Sharrit ne bëme një ëndërr të vërtetë - krijuam mjedisin për të mbrojtur si traditën tonë, po ashtu edhe të ardhmen tonë nëpër fshatra. Turizmi i qëndrueshëm do të krijojë vende të reja pune, të ardhura më të mira dhe mundësi të reja jo vetëm në qytet, por edhe nëpër fshatra. Ne do t'i modernizojmë fshatrat pa e dëmtuar karakterin e tyre unik dhe do të investojmë në infrastrukturën moderne, objektet turistike dhe në rinovim. Me subvencionet për akomodimin turistik do t'i ndihmojmë banorët e fshatrave që t'i krijojnë bizneset e tyre turistike nëpërmjet krijimit të një marke të ushqimit organik të Malit Sharr, kurse nëpërmjet një programi të veçantë për fermerët do ta nxisim bujqësinë. Me kurse profesionale të organizuar nëpër fshatra ne do të ofrojmë arsimim formal nëpër fshatra në mënyrë që të trajnojmë menaxherët e turizmit, të krijojmë guida turistike dhe të hapim vende të tjera të reja të punës.

Mundësi më të mira, të ardhura më të mira dhe jetë më të mirë në fshatrat e Tetovës - Kjo do të thotë, gjithashtu, një përmirësim i shërbimeve publike në zonat jashtë qytetit. Ne do ta lidhim qytetin me fshatrat nëpërmjet linjave moderne të autobusëve publikë. Ne do të ndërtojmë pika për shërbimet publike së bashku me zyrat turistike në fshatra në mënyrë që qytetarët të marrin të gjitha shërbimet publike afër vendit ku jetojnë. Nëpërmjet orëve javore të prezantimit të kryetarit në çdo fshat, me qytetarët do të vendosim kontakt të drejtpërdrejtë dhe personal me kryetarin e komunës.



**Përgjatë katër viteve realizuam:**



**Asfaltimi i rrugës për në fshatin Shipkovicë me gjatësi 3 km**



**Asfaltimi i rrugës Brodec - Veshallë**





Ndërtimi i rrugës së banjës

- Ndërtimin e rrugës së Banjës dhe instalimin e ndriçimit publik;
- Ndërtimin e vendi për piknik në lokacionin Banja e Tetovës;
- Asfaltimin e rrugës për në fshatin Sellcë (nga shpati në qendër të fshatit) me gjatësi 1.4 km;
- Shtrimin me bekatonë, asfaltimin dhe rindërtimin e rrugës në fshatin Brodec, me gjatësi 700 m;
- Rindërtimin dhe rehabilitimin e rrugës lokale Tetovë – Bërvenicë;
- Ndërrimi e pllakave të bekatonit në rrugën kryesore para shkollës fillore “Përparimi” dhe ndërtimi e një fushe sportive shumëfunktionale në Reçicën të Madhe;
- Ndërtimin e sistemit për menaxhimin me ujërat e zeza atmosferike në fshatin Xhepçisht dhe fshatin Saraqinë;
- Rregullimi e rrjedhës së ujit në fshatin Shipkovicë, si dhe matjet për minimizimin e rrezikut nga përmytjet;
- Ndërtimin e urës në rrugën Shipkovicë – Brodec;
- Rindërtimin e rrugës Tetovë – Trebosh;



### Projektet e ardhshme:

- Vazhdimi i Rrugës së Banjës - Një nga prioritetet tona, për sa i takon pikave rekreative për qytetarët tanë, ka qenë investimi i vazhdueshëm në atë që quhet “Ruga e Banjës”. Me këtë investim në infrastrukturën rrugore, me instalimin e ndriçimit publik dhe vendosjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik, tanimë faza tjetër parashihet financimin e vazhdimit të rrugës përmes aplikimit në Agjencinë për Zhvillim Rural.
- Shenjzimi i shtigjeve malore.
- Masa konkrete për fshatrat në bashkëpunim me Parkun Nacional Sharri.
- Rikonstruktimi i plotë i rrugës nga Kolltuku deri në fshatin Vicë.
- Vendosje të sistemit të kanalizimit për të dy anët e malësisë



3

**Mjedisi:**  
Drejt së ardhmes, pastër  
dhe gjelbër!

E ardhmja jonë është e gjelbër. Ne duam që fëmijët tanë të rriten në një mjedis të shëndetshëm. Ne duam që të jetojmë në një qytet të pastër dhe të gjelbër. Menaxhimi i mbeturinave dhe ndotja janë dy çështje kryesore të qytetit tonë dhe ne e dimë se komuna nuk ka vazhduar gjithmonë me atë që qytetarët, me të drejtë, e presin. Ne tashmë kemi filluar investimet tona në një qytet të gjelbër, me katër kamionë të rinj për grumbullimin e mbeturinave, dy automjete speciale për pastrimin e rrugëve dhe 150 kontejnerë të rinj. Përveç kësaj, ne tashmë kemi aplikuar dhe e kemi fituar projektin për vendosjen e kontejnerëve gjysmë nëntokësorë në 30 vende, me qëllim që ta mbajmë qytetin të pastër.

Në mandatin e ardhshëm do ta ristrukturojmë ndërmarrjen e shërbimeve publike në një ndërmarrje moderne, efektive dhe të orientuar drejt shërbimit. Do të krijojmë linjë telefonike për qytetarët që do të informojnë për çdo papastërti në qytet dhe do të krijojmë një grup të përhershëm për ndërhyrje të shpejtë me qëllim që ta mbajmë qytetin sa më të pastër. Ne do ta zbatojmë inspektimin që ta shmangim ndotjen.

Parqet, terrenet e lojërave dhe zonat e tjera të gjelbra në qytet do të pastrohen, rinovohen dhe mbrohen. Do të krijohen zona të reja rekreative, duke ndërtuar hapësira të gjelbra, me pemë, në sheshin kryesor. Do të rinovohet bregu i lumit, duke përfshirë edhe qendrat e fitnesit në natyrë, si dhe hapësirat rekreative. Çdo ndërtesë e re duhet të kompensohet me hapësirë të gjelbër dhe pemë.

Për ta luftuar ndotjen e ajrit dhe për të kaluar në energji të gjelbër dhe të qëndrueshme, ne do të subvencionojmë instalimin e inverterëve dhe sistemeve të tjera eko-miqësore të ngrohjes, si dhe do të ketë subvencione të veçanta për gjelbërimin dhe kopshtarinë urbane. Në të gjithë ndërtesat publike do të instalojmë panele diellore dhe sisteme fotovoltaike, siç kemi bërë tashmë në shkollën e mesme “7 Marsi”, shkollën fillore “Skënderbeu” dhe në stacionin e filtrimit të ujit.

**Përgjatë katër viteve realizuam:**

Furnizimin e NPK -së me  
4 kamionë



Zgjidhje  
voto blerte





- Furnizimin e NPK -së me 4 kamionë për grumbullimin e mbeturinave, 2 automjete speciale për pastrimin e rrugëve dhe 150 kontejnerë.
- Pastrimin e deponisë në fshatin Falisht.
- Ndërtimin e parkut të Xhamisë së Pashës.
- Ndërtimin e parkut në Bllokun 82.
- Subvencionimin e 1500 qytetarëve dhe familjeve me pajisje inverter.
- Furnizimin e shkollës “Naim Frashëri” me pajisje inverter.
- Furnizimin e shkollës Migjeni, lokacioni Qendra Sportive me pajisje inverter.
- Instalimin e sistemeve fotovoltaike në shkollën e mesme “7 Marsi”, në shkollën fillore “Skënderbeu”, në Proj dhe në stacionin për filtrimin e ujit në fshatin Lisec.

### Projektet e ardhshme:

- Kontejnerët gjysmë nëntokësor - Qëllimi kryesor i projektit është përmirësimi i shërbimeve komunale në Komunën e Tetovës nëpërmjet Ndërmarrjes Publike Komunale ‘Tetova’. Projekti konsiderohet si hap më tej në përmirësimin e kapaciteteve të ndërmarrjes publike dhe në ofrimin e shërbimeve nga kjo ndërmarrje. Projekti parasheh vendosjen e katër llojeve të ndryshme të kontejnerëve gjysmë nëntokësor në 30 lokacione. Të gjithë lokacionet janë zgjedhur duke u bazuar në analizën dhe parametrat

hyrës, si: zona në qendër të qytetit, sheshet publike urbane, parqet, përvoja e mëparshme me mbeturinat në ato zona, ngarkesa në terren për sektorin aktual të biznesit dhe numrin e popullsisë që jeton aty pranë.

- Furnizimi i të gjitha shkollave me inverter dhe pastrues ajri.
- Subvencione për energji efiçiente – termo-izolim.
- Rregullimi i shtratit të lumit pas rrugës industriale.
- Ndarja e NPK-së në 2 drejtori – Me qëllim të përshtatjes të punës së deritanishme për të përmbushur nevojat e reja dhe për realizimin më efikas, racional dhe në kohë, NP “Tetova”, gjatë mandatit vijues, do të ndahet në dy drejtori të veçanta, edhe atë:

NP HIGJIENA KOMUNALE –TETOVA  
NP “UJËSJELLËSI DHE KANAZILIMI”-TETOVË

4

**Gazifikimi:**  
Energji e lirë dhe ekologjike  
për të gjithë!

Gjatë katër viteve të ardhshme në komunën e Tetovës do të fillojë edhe gazifikimi. Brenda katër viteve të ardhshme, 50% e rrjetit të planifikuar të shpërndarjes do të ndërtohet në komunën e Tetovës, në përputhje me studimin ekzistues të fizibilitetit, një studim i kryer në vitin 2014 dhe i financuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.



Në vijim, në Ministrinë e Ekonomisë është përfunduar procedura për partneritetet publike – private. Kjo procedurë do të përfundojë deri në fund të vitit 2021. Partneri privat do të ketë si detyrim që ta projektojë, ndërtojë dhe mirëmbajë rrjetin e shpërndarjes.

Gazifikimi do t'u mundësojë familjeve, industrive dhe bizneseve që të kenë energji alternative, të pastër, ekologjike dhe shumë më të mirë. Kostoja e lidhjeve të reja do të jetë më pak se 100 euro dhe komuna do t'i subvencionojë pjesërisht këto shpenzime për të gjitha familjet dhe plotësisht për familjet me ndihmë sociale.



Zgjidhjet  
voto blertë





5

**Arsimi:  
Shkolla më të mira, për  
mundësi më të mira!**

Ne investuam 100 milionë denarë në rinovimin e të gjithë kopshteve dhe shkollave në komunën e Tetovës. Qeveria investoi 60 milionë denarë për ndërtimin e katër sallave sportive shkollore. Në kohët e fundit e kemi hapur shkollën e re fillore “Naim Frashëri” në Reçicë, që është një mjedis i ri dhe i përsosur për fëmijët tanë dhe i ndërtuar sipas standardeve më moderne perëndimore. Në shkollën fillore “Kirili dhe Metodi” tashmë kemi aplikuar për ndërtimin e kopshtit për 250 fëmijë.

Ne krijuam një qendër rajonale të arsimit profesional, e cila, së shpejti, do të ketë klasa të decentralizuara nëpër fshatra, në mënyrë që t’u sigurojë të rinjve nëpër fshatra, veçanërisht t’u sigurojë grave të reja një arsim formal dhe lehtësisht të arritshëm. Ne kemi hapur tashmë qendra të përhershme zhvillimi për fëmijët në të gjithë komunën dhe do të ndërtojmë edhe më shumë objekte për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve në qytet dhe në fshatra. Ne do të sigurohemi që numri i nxënësve për klasë të mos jetë më i lartë se 20, me qëllim që të sigurohet edukim individual dhe promovim i talenteve. Ne besojmë se arsimi është çelësi i një jete më të mirë për fëmijët tanë dhe jemi plotësisht të përkushtuar për ta siguruar infrastrukturën më moderne dhe më të përparuar. Në kohën e pandemisë, ne jo vetëm që do t’i pajisim të gjitha shkollat tona me pastrues ajri, por gjithashtu do të krijojmë fond të veçantë për studentët në nevojë, për t’i pajisur ata me pajisjet e nevojshme për klasa në distancë dhe mësim elektronik.

### **Përgjatë katër viteve ne realizuam:**

- Ndërtimin e shkollës së re fillore “Naim Frashëri” në Reçicën e Vogël.
- Hapjen e të gjitha profileve të ndryshme arsimore.
- Themelimin e Qendrës Rajonale për Arsimin e Mesëm Profesional në Tetovë
- Hapjen e Qendrave të Zhvillimit të Përhershëm për fëmijët në Xhepçisht, Shipkovicë, Brodec, Lisec, Gajre, Sellcë, Saraqinë, Falisht, Reçicë e Madhe, rruga “Migjeni”, rruga “Teteks”.

### **Projektet e ardhshme:**

- Ndërtimi i një çerdheje të re në afërsi të shkollës fillore “Kirili dhe Metodi”, me kapacitet për 250 fëmijë dhe sipas standardeve më bashkëkohore.
- Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Sellcë.
- Me hapjen e qendrave për zhvillimin e hershëm të fëmijëve edhe në fshatrat Xhermë, Poroj, Vicë do t’i kompletojmë të gjitha vendbani met rurale me çerdhe.
- Do të vazhdojmë me procesin e etablimit të mësimin me një ndërrim në shkollat fillore të komunës tonë.
- Do të përfundojmë procesin e digjitalizimit të të gjithë shkollave dhe furnizimit të plotë të tyre me tabela digjitale.





Shkolla në fshatën Selcë

- Do të vazhdojmë me procesin e vendosjes së inverterave, paneleve për energji diellore deri në kompletim të plotë të tyre.
- Do të vazhdojë procesi i rikonstruktimit, zgjerimit të kapaciteteve të tyre dhe modernizimit të shkollave.
- Do të vazhdojë procesi i modernizimit të bibliotekave, pasurimi i fondit të librave dhe do të ndërtohen leximore në objektet shkollore.



Zgjidh jetë  
voto blertë



- Vazhdon etablimi i kriterëve për regjistrim, si një instrument për rritjen e cilësisë dhe krijimin e ekuilibrit në regjistrimin e nxënësve në të gjitha shkollat e mesme të komunës.
- Përforcimi i mësimit kabinetik duke krijuar kushtet e nevojshme me pajisjet e domosdoshme për proces mësimor kreativ dhe në përputhje me drejtimet përkatëse.
- Do të vazhdojë përforcimi i shkollave të mesme profesionale, duke investuar në krijimin e të gjitha kushteve për të siguruar performancë arsimore në përputhje me tregun e punës – drejtim i mesëm për IT.
- Ushqim falas për çdo fëmijë.
- Vendosja e notit si lëndë sportive shtesë.
- Fond i veçantë për nxënës në gjendje të rëndë sociale dhe për nxënës të shkëlqyeshëm.





Sporti dhe kultura janë të një rëndësie të madhe jo vetëm për shëndetin dhe argëtimin e njerëzve, por edhe për jetën shoqërore në komunën tonë. Gjatë katër viteve të kaluara kemi investuar shumë: hapëm pishinën e re për fëmijë në qendrën sportive të Tetovës, ndërtuam salla dhe fusha sportive nëpër shkollat fillore dhe të mesme dhe rinovuam skate-parkun. Festalet “Vera e kulturës së Tetovës” dhe “Tetova feston Nëntorin” janë tashmë pikat kryesore të vitit tonë kulturor.

Në katër vitet e ardhshme ne do t’i pajisim të gjitha shkollat e mbetura me salla sportive dhe fusha sportive. Ne do të shtrijmë korsitë e biçikletave në të gjithë qytetin. Bregu i ri i lumit do të pajiset me palestra funksionale në natyrë. Ne do të ndërtojmë edhe më tej fusha sportive dhe palestra në natyrë edhe nëpër fshatra, si dhe shtigje të shënuara për biçikleta malore.

Ndërtesa e vjetër do t’u kthehet qytetarëve, si qendër e re multifunksionale për sportin dhe kulturën. Kështu do t’i jepet hapësirë kryesisht rinisë dhe iniciativave kulturore lokale. Me një thirrje të hapur ne do të ftojme artistët e Tetovës të paraqesin idetë e tyre për artin në hapësirën publike dhe ta kthejnë qytetin tonë në një ekspozitë të përhershme në ambient të hapur. Për nënkulturën e re do të sigurojmë hapësira falas për art – grafite dhe vepra të tjera arti.

### **Përgjatë katër viteve realizuam:**

- Ndërtimin e një pishine për fëmijë në qendrën sportive në Tetovë.
- Hapjen e Akademisë së sporteve dhe profileve - drejtimeve artistike në dy gjimnazet.
- Ndërtimin e sallave sportive dhe terreneve sportive në shkollat fillore dhe të mesme.
- Ndërtimin e fushave sportive, fushave shumëfunksionale për futboll, basketboll dhe volejball në Poroj, Reçicë e Madhe dhe në shkollën fillore “Kirili dhe Metodi”.
- Organizimin e 8 edicioneve të manifestimit tradicional “Vera e kulturës tetovare”.
- Organizimin e manifestimit tradicional “Tetova feston Nëntorin”.
- Mbështetje për ngjarje të ndryshme kulturore dhe sportive.

### **Projektet e ardhshme:**

- Qendër sportive dhe rinore të hapësira e qendrës sportive.
- Qendër fitnesi në kuadër të rindërtimit të shëtitores përgjatë lumit Shkumbin.
- Themelimi i ndërmarrjes për menaxhim me objektet sportive.
- Subvencionimi i shoqërive kulturore.
- Institucionalizimi i festivalit “Vera e kulturës tetovare”, si drejtori e veçantë dhe e financuar nga Qeveria.



Vera e Kulturës Tetovare



Tetova Feston Nëntorin



TETOVA FESTON NËNTORIN 2018



7

**Rinia:**  
Tetova për brezin e ri!

Tetova ka qenë gjithmonë një qytet i gjallë dhe me një rini aktive. Kohëve të fundit u rindërtua dhe u rihap Qendra Rinore të ish - Radio Tetova. Me krijimin e këshillit tonë rinor lokal, ne u dhamë qytetarëve të rinj një zë për t'i shprehur mendimet dhe kërkesat e tyre. Në vitet në vijim, ne do të punojmë edhe më shumë që t'i përmbushim këto kërkesa, do të krijojmë më shumë hapësira rekreative dhe mundësi më të mëdha për të rinjtë tanë.

Ne do ta shtrijmë skate parkun e sapo rinovuar në një park rinor shumëfunksional, ku brezi ynë i ri do t'i ketë të gjithë mundësitë që të përfshihet në zhvillim. Qendra e re shumëfunktionale e sportit dhe kulturës në hapësirën e Qendrës sportive do të lehtësojë jo vetëm një qendër të dytë rinore, por do të ketë edhe salla provash shumëfunktionale për muzikantët dhe artistët e rinj. Përveç kësaj, ne do të ndërtojmë në të gjitha fshatrat hapësira rekreative, objekte sportive dhe salla takimesh për të rinjtë.

Komuna, bashkë me ekonominë lokale, do të krijojë një shkollë verore dhe një program praktik për të përgatitur të rinjtë tanë për karrierën e tyre profesionale dhe për të krijuar kontakte me punëdhënësit e mundshëm.

Meqenëse transporti është një çështje e rëndësishme për qytetarët tanë të rinj nëpër fshatra, ne jo vetëm që do t'i lidhim fshatrat me qendrën e qytetit me linja të rregullta autobusi gjatë ditës, por gjithashtu do të vendosim linja nate gjatë fundjavës, të cilat do të sigurojnë transport të sigurt midis qendrës së qytetit dhe fshatrave.

### **Përgjatë katër viteve realizuam:**

- Rekonstruktimin e Qendrës Rinore në hapësirat e ish - Radio Tetovës.
- Themelimin e Këshillit Rinor Lokal.

### **Projektet e ardhshme:**

- Përforcimi i Këshillit Rinor Lokal nëpërmjet organizimit të aktiviteteve mujore për të rinjtë.
- Vend rekreativ për të rinjtë – me fillimin e ndërtimit të shëtitorës përkaj lumit Shkumbin, planifikojmë edhe ndërtimin e pikave për rekreacion. Po ashtu, si pjesë shtesë e projektit do të jetë edhe ndërtimi i një amfiteatri të hapur, me synimin që të zhvillohet jeta rinore në qytet.
- Programe verore – me qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, sportit të rinjtë.
- Dislokim i kazinove.
- Organizimin e ditës së karrierës në bashkëpunim me shkollat e mesme dhe bizneset.
- Transport për të rinjtë nga fshatrat e Tetovës.

Zgjidh jetë  
voto blertë



Zgjidh jetë  
voto blertë



8

## Zhvillimi ekonomik: Ekonomi e gjelbër për vende të reja pune!



Agjenda jonë e gjelbër nënkupton jo vetëm mbrojtjen e mjedisit tonë, por edhe një nxitje për ekonominë tonë. Me krijimin e Parkut Kombëtar të Malit Sharr ne do ta nxisim turizmin dhe bujqësinë nëpër fshatra, duke investuar në turizëm të qëndrueshëm dhe duke u siguruar qytetarëve në fshatra subvencione dhe trajnime për krijimin e bizneseve të tyre turistike si dhe krijimin e një marke të mbrojtur “Ushqime nga Mali Sharr” për prodhimin vendor të ushqimit organik.

Subvencionet për ndërtimin dhe ngrohjen miqësore me mjedisin do të krijojnë vende të reja pune në biznesin lokal të ndërtimit dhe ne do të krijojmë një program për bizneset e vogla dhe të mesme për t'i mbështetur financiarisht inovacionet. Në bashkëpunim me universitetet tona dhe bizneset, ne do të ndërtojmë një qendër për teknologjitë e reja të gjelbra dhe një qendër për sipërmarrësit e rinj.

Me iniciativën e re “Investo në Tetovë” do të tërheqim investitorë të huaj, veçanërisht do t'i mundësojmë diasporës sonë që të investojë në komunën tonë, si dhe do të hapim një zyrë të veçantë për investimet e huaja, me qëllimin që investitorëve potencialë t'ua ofrojmë shërbimet e nevojshme për bizneset e tyre të reja në Tetovë.

### **Përgjatë katër viteve, ne realizuam:**

- Forcimin strategjik të arsimit profesional në përputhje me tregun e punës.
- Zbatimin e suksesshëm të projekteve për angazhimin e personave të papunësuar, si dhe angazhimin e grupeve të marginalizuara për punë të përkohshme, financuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.
- Ndërtimin e lidhjeve infrastrukturore të qytetit me fshatrat e komunës sonë dhe me komunat përreth për një zhvillim më të mirë ekonomik.


### **Projektet e ardhshme:**

- Vend i përbashkët për punë në bashkëpunim me universitetin në qytet (coworking space).
- Shkollë profesionale për IT – lokacioni Shkolla e Mesme e Mjekësisë.
- Fond inovativ për biznese të vogla, me fokus në digjitalizim dhe ekonomi të gjelbër.
- Platformë turizmi për Tetovën, ueb faqe dhe aplikacion.
- Zhvillim i produkteve organike në bashkëpunim me Parkun Nacional Sharrin.
- Zyrë investimi – që do të mundësojë lidhje më të afërta të tetovarëve nëpër botë me qytetin e tyre, me fokus te njerëzit e biznesit që duan të investojnë në vendlindje.

Zgjidhjetë  
voto blertë



Zgjidhjetë  
voto



9

**Shërbimet publike dhe transparencja:  
Komuna në shërbim të  
qytetarit!**

Takse pronësie

KOMUNA E  
TETOVËS

Komuna në shërbimin tuaj – ky është synimi ynë për katër vitet e ardhshme. Qëllimi ynë është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për qytetarët, një administratë më transparente e efikase dhe përfshirja e qytetarëve në të gjitha vendimet kryesore për komunën.

Duke ndërtuar një qendër moderne të shërbimit komunal jashtë qendrës së qytetit, e cila do të jetë gjithashtu shtëpia e re për komunën e qytetit, ne krijojmë një qendër ku qytetarët do të pajisen me të gjitha shërbimet publike në një pikë të vetme kontakti. Zhvendosja, gjithashtu, do të krijojë kushte që hapësira e tanishme e komunës të kthehet në një qendër parkimi, e nevojshme për qendrën e qytetit.

Qytetarët, nëpërmjet digjitalizimit të plotë të shërbimeve tona, mund të ndjekin kërkesat e tyre dhe të shohin statusin në kohë reale. Digjitalizimi, gjithashtu, do ta rrisë transparencën dhe do ta parandalojë korrupsionin në administratë. Më tej, ne do të instalojmë një Ombudsman të pavarur dhe një platformë anonime sinjalizuese digjitale ku qytetarët mund të raportojnë incidente në administratë. Të gjithë pozicionet drejtuese në administratën publike do të verifikohen, që d.t.th. një kontroll i dyfishtë mbi kualifikimin e tyre ligjor, moral dhe profesional.

Ne angazhohemi për një politikë të dyerve të hapura, që do të thotë se kryetari i komunës do të mbajë takime me qytetarët një herë në dy javë - jo vetëm në komunën e qytetit, por edhe në zyrat e reja të shërbimit publik në fshatra.

Komuna është e qytetarëve. Prandaj, qytetarët do të kenë të drejtën që të vendosin për të gjithë vendimet kryesore në komunë. Kryetari i komunës do të mbajë referendum për të gjithë projektet dhe vendimet kryesore.

Gjithashtu, do të zbatojë modele moderne të pjesëmarrjes demokratike për të gjithë projektet në hapësirat publike, ku qytetarët që në fillim do të integrohen në zhvillimin e projektit. Qytetarët mund të propozojnë projekte në lagjet e tyre dhe ata do të votohen nga qytetarët, Këshilli Komunal dhe do të zbatohen nga komuna.

### **Përgjatë katër viteve realizuam:**


- Takime të kryetares së komunës me qytetarët në bazë të rregullt – ditë e hapur në çdo të dytën javë.
- Mbajtja e forumeve ku qytetarët kanë zgjedhur projekte prioritare për zbatim (Rindërtimi i ambienteve të Qendrës Rinore dhe rindërtimi i kopshtit në Qendrën Sportive).

### **Projektet e ardhshme:**

- Zgjidhjet inovative të shërbimeve komunale në komunën e Tetovës do të mundësojnë digjitalizimin e shumicës së shërbimeve komunale, trajnimin e administratës dhe qytetarëve/bizneseve në përdorimin e këtyre shërbimeve.

Me implementimin e platformës digjitale të informacionit gjeo-informativ TIK, synimi ynë është integrimi i të gjithë proceseve manuale komunale në nivel digjital. Shërbimet e inspektimit do ta përshpejtojnë përgatitjen e raporteve nga inspektimi në terren; lëshimin e ekstrakteve nga planet urbanistike në formë të automatizuar; sigurimin e të dhënave për planifikimet e shtëpive; prezantimin publik të planeve urbanistike të përgatitura; përpunimin e kërkesave dhe lëshimin e certifikatave nga qytetarët e kompanitë, mbledhjen e taksave dhe shërbimet tjera komunale.

Zgjidhjet e  
v




Zgjidhjet e  
v



Përmes promovimit të aplikacionit në të gjithë sektorët komunal, përdorimi i shërbimeve digjitale do të transformojë komunën, sepse do të ris kapacitetin financiar dhe do të sigurojë që bizneset/qytetarët t'i marrin dokumentet në kohën e duhur.

Këto zgjidhje inovative nëpërmjet moduleve do të kenë qasje në ueb dhe në aplikacione përmes celularëve, që do të shfrytëzohen nga qytetarët, duke kontribuar kështu në planin tonë për një komunë digjitale.

- Raport 100 ditore i kryetarit të komunës.
- Derë e hapur – qytetarët do të mund të takojnë kryetarin çdo të dytën javë.
- Ombudsman në komunë.
- Stacion për zjarrfikës në rajonet malore të komunës.



10

**Shëndeti dhe mbrojtja sociale:  
Një komunë që kujdeset për  
të gjithë!**

Shëndeti dhe mbrojtja sociale kanë qenë gjithmonë një shtyllë e politikës së krytares, me tendencë të përparimit të mëtutjeshëm. Së bashku me ekonominë lokale, ne do të krijojmë një kartë sociale për të gjithë qytetarët në vështirësi, që t'i përballojnë harxhimet për ushqimet e tyre të përditshme. Nëpërmjet kësaj karte do të jenë falas shërbimet publike, sikurse transporti publik. Mbajtësit e kartës do të kenë të drejtë të marrin falas një sasi të kufizuar të ushqimeve bazë, nën koston e komunës. Për personat me pengesa në zhvillim, të moshuarit pa mbështetjen e familjes, ne do të krijojmë një shërbim për shpërndarjen e produkteve për nevojat e përditshme. Çelësi për t'i integruar njerëzit me lëvizshmëri të kufizuar në shoqërinë tonë dhe për t'i bërë të gjithë shërbimet publike plotësisht të arritshme për ta është qasja jonë. Gjithashtu, do të instalojmë rampa për karrige me rrota dhe sistem udhëzues për njerëzit e verbër nëpër të gjitha rrugët kryesore të qytetit dhe do t'i inkurajojmë bizneset private që ta përmirësojnë qasjen ndaj tyre. Do të ndërtojmë banesa sociale, duke ofruar apartamente të përbalueshme për njerëzit në nevojë. Banesat sociale do të zbatohen në partneritet me ndërtuesit privatë dhe pronarët e apartamenteve dhe me mbështetje nga komuna.

### **Përgjatë katër viteve realizuam:**

- Mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara përmes asistentëve arsimorë në 10 shkolla fillore.
- Hapja e Qendrës së Kujdesit Ditor për fëmijët me pengesa në zhvillim të moshës 2-14 vjeç.
- Kuzhina tradicionale ka vazhduar çdo ditë me gatimin e 100 vakteve për fëmijët e varfër.
- Janë dhënë tableta për të gjithë nxënësit e familjeve me përkujdesje sociale për të ndjekur mësimin online.
- Është siguruar internet falas për këta studentë që ta ndjekin mësimin online.
- Është hapur dhe funksionon Qendra për Shërbime Sociale në kuadër të Komunës së Tetovës.
- U hap kabineti i Alfabetit Bra për studentët me shikim të dobët ose të verbër. Një mësim aktiv për këta studentë u organizua për çdo ditë në këtë kabinet.
- Organizuam turneun ndërkombëtar në SHAH për personat e verbër.
- Është themeluar dhe funksionon Këshilli për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

### **Projektet e ardhshme:**

- Bukë falas për çdo familje në gjendje të rëndë sociale.
- Ndërtimi i banesave sociale.
- Sigurimi që çdo institucion publik të ketë infrastrukturë të përshtatur për personat me pengesa në zhvillim.

Zgjidhjetë  
voto blertë



Zgjidhjetë  
voto blertë



11

**Siguria:**  
Tetova, një qytet i sigurt  
për të jetuar!



Për ta rritur sigurinë në qytetin tonë, ne do të krijojmë një polici komunale që do ta mbështesë policinë shtetërore në zbatimin e ligjit, do t'i sigurojë rrugët, veçanërisht para shkollave dhe çerdheve dhe do ta kontrollojë dhe menaxhojë trafikun dhe parkimin. Kjo polici komunale, e paarmatosur, gjithashtu do të jetë përgjegjëse për ta shmangur ndotjen e qytetit dhe për t'i kontrolluar rregulloret në hapësirën publike.

Një ndër masat e para do të jetë përmirësimi i ndriçimit të rrugëve në Tetovë me drita moderne diellore, të cilat jo vetëm që do të mbushen gjatë ditës dhe do të lëshojnë dritën e tyre gjatë natës, por edhe do të prodhojnë energji ekologjike shtesë dhe do të shërbejnë si WiFi falas në pikat kryesore në qytet.

Së bashku me qeverinë ne do t'i heqim kazinotë nga qendra e qytetit. Kryetarja Teuta Arifi, me presion të vazhdueshëm në nivel lokal dhe BDI në nivel qendror, mundësuan sjelljen e një ligji të ri në parlament, i cili imponon distancën prej 500 metrash për kazinotë dhe bastoret sportive rreth shkollave. Kjo do të thotë se shumica dërrmuese e kazinove në Tetovë do të mbyllën ose do të zhvendosen jashtë qytetit.

Edhe pse kryetarja e komunës tashmë ka zbatuar një program për ta çliruar qytetin nga qentë endacakë, ne duhet t'i intensifikojmë aktivitetet për t'i mbrojtur qytetarët nga incidentet. Ne do të angazhohemi për një politikë të tolerancës zero për qentë endacakë dhe do të zbatojmë një plan veprimi të qëndrueshëm për ta bërë Tetovën të lirë nga qentë endacakë.

### **Përgjatë katër viteve realizuam:**

- Falë aktiviteteve të shumta të kryera, masave parandaluese, funksionimit të trekëndëshit pedagogjik dhe bashkëpunimit ndërinstitucional me Njësinë për Punë të Brendshme në Tetovë, arritëm që të krijojmë mjedise të sigurta shkollore. Në periudhën 8 vjeçare numri i shqetësimeve të rendit publik në dhe rreth shkollave u zvogëlua për 8 herë. Ne arritëm të kemi vetëm 4 shqetësime të rendit publik në vitin shkollor 2019/2020, kurse në 2020/2021 asnjë shqetësim të rendit publik në dhe pranë shkollave fillore dhe të mesme.

### **Projektet e ardhshme:**

- Polici komunale – me qëllim që të rritet siguria dhe mbarëvajtja e rendit në qytet, do të themelojmë polici komunale.
- Kamera sigurie në vende të caktuara në qytet.
- Ndriçim në të gjithë zonat e qytetit.
- Trajtim për qentë endacakë.

Zgjidh jetë  
voto blertë



Zgjidh jetë  
voto blertë







12

**Barazia:**  
Të drejta të barabarta,  
mundësi të barabarta!

Tetova është qyteti i parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut që ka një grua kryetare komune. Kjo është një arritje me të cilën mund të jemi krenarë dhe është pikë referimi për barazinë gjinore dhe për një shoqëri moderne në vendin tonë. Qëllimi ynë është që të rrisim raportin në pozicionet drejtuese në 50:50 në katër vitet e ardhshme. Duke ndërtuar objekte të kujdesit ditor në të gjithë qytetin, ne tashmë i kemi mbështetur me sukses gratë për ta kombinuar familjen me profesionin. Ne do të vazhdojmë me këtë mënyrë të suksesshme dhe do të ofrojmë mundësi gjithnjë e më fleksibile.

Për ta rritur shkallën e punësimit të grave nëpër fshatra, do të ofrojmë trajnime dhe programe të veçanta edukimi për të ofruar mundësi karriere në sektorin publik dhe privat.

Së bashku me shkollat tona, universitetet dhe ekonominë, do të krijojmë program të veçantë për t'i motivuar vajzat dhe gratë e reja për edukim teknik dhe karrierë.

Më tej, ne do t'i shtojmë përpjekjet tona për t'i mbrojtur gratë nga dhuna në familje duke instaluar linjë anonime të ndihmës dhe duke ndërtuar një shtëpi të sigurt për gratë në Tetovë. Aty gratë do të mund të gjejnë strehim dhe mbrojtje të menjëhershme.

### **Përgjatë katër viteve realizuam:**

- Komuna e Tetovës është pjesë e nismës për përmirësimin e kushteve për integrimin e grave në tregun e punës.
- Një ndër synimet kryesore ka qenë vendosja e grave si drejtuese të institucioneve.

### **Projektet e ardhshme:**

- Ulje të tarifës për leje ndërtimi nëse pronari është grua.
- Programe karriere për gra.
- Hapësira për qëndrim për gra të rrezikuara nga dhuna.



**Zgjidh jetë  
voto blertë**

